

VENDIM
Nr. 83, datë 30.6.2015

PËR LICENCIMIN E SHOQËRISË “GAMA ENERGY” SHPK, NË AKTIVITETIN E PRODHIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE NGA HEC-et: “LENA 1”, ME FUQI TË INSTALUAR 1.95 MW, “LENA 2” ME FUQI TË INSTALUAR 2.3 MW DHE “LENA 2A”; ME FUQI TË INSTALUAR 0.25 MW (ME FUQI TOTALE 4.5 MW)

Në mbështetje të neneve 2, germa “c”; 16; 37, pika 2, germa “a” dhe 39, pika 3, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”; neneve 4, pika 1, germa “a”; 5, pika 1, germa “a”; dhe 13 të rregullores “Për procedurat e licencimit, modifikimit, transferimit të plotë/të pjesshëm dhe rinovimit të licencave”, të miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 108, datë 9.9.2008, Bordi i Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 30.6.2015, pasi shqyrtoi aplikimin e paraqitur nga shoqëria “Gama Energy” sh.p.k., si dhe relacionin e Drejtorisë së Licencimit dhe të Monitorimit të Tregut dhe Drejtorisë Juridike dhe të Mbrojtjes së Konsumatorit për licencimin në aktivitetin e prodhimit të energjisë elektrike të kësaj shoqërie nga HEC-et: “Lena 1”, “Lena 2” dhe “Lena 2A”,

konstatoi se:

Aplikimi i shoqërisë “Gama Energy” sh.p.k. plotëson tërësisht kërkesat e parashikuara nga ERE në rregulloren “Për procedurat e licencimit, modifikimit, transferimit të plotë/të pjesshëm dhe rinovimit të licencave”, si më poshtë:

- Format i aplikimit (neni 9, pika 1) është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte;
- Dokumentacioni juridik, administrativ dhe pronësor (neni 9, pika 2) është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte;
- Dokumentacioni financiar dhe fiskal (neni 9, pika 3) është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte;
- Dokumentacioni teknik lidhur me tipin e licencës (neni 9, pikat 4.1.1, 4.1.2, 4.1.3, 4.1.4, 4.1.5) është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Të licencojë shoqërinë “Gama Energy” sh.p.k., në aktivitetin e prodhimit të energjisë elektrike nga HEC-et: “Lena 1”, me fuqi të instaluar 1.95 MW; “Lena 2”, me fuqi të instaluar 2.3 MW dhe “Lena 2A”, me fuqi të instaluar 0.25 MW (me fuqi totale 4.5 MW), për një afat 30-vjeçar.

2. Drejtoria e Licencimit, të Monitorimit të Tregut dhe të Licencuarve të njoftojë aplikuesin për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Petrit Ahmeti